

**VENDIM**  
**Nr. 161, datë 18.7.2025**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GRABOVA HYDROPOWER” SHPK NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38 pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 20/18 prot., datë 17.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Grabova Hydropower’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Grabova Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2595 prot., datë 20.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 1”, me kapacitet të instaluar 14.9 *mw*, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, qarku Elbasan.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 5, datë 6.1.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Grabova Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.1.2025 dhe 8.1.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 5.2.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 20/2 prot, datë 9.1.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke i kërkuar gjithashtu që të bëjë me dije në rast se ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratave, por nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë në lidhje me plotësimin e informacionit/dokumentacionit të munguar, u vlerësua e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore me shoqërinë për të sqaruar afatet e vlefshmërisë së VNM-së, ndaj ERE-s, me vendimin nr. 58, datë 10.3.2025, vendosi zgjatjen e vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë për licencim në aktivitetin e prodhimit me 30 (tridhjetë) ditë.

- Pas zhvillimit të seancës dëgjimore dhe korrespondencës përkatëse me shoqërinë, me vendimin e Bordit nr. 73, datë 10.4.2025, u vendos pezullimi i vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë për licencim, duke i lënë detyrë asaj që brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve të depozitojë në ERE qëndrimin/vendimin e AKM-së për aplikimin e bërë për pajisjen me VNM të re, si dhe të depozitojë qëndrimin e MIE-s apo amendimin e mundshëm të kontratës së koncesionit në lidhje me afatet e ndërtimit dhe vënies në punë të hidrocentralit.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 73/2025 me shkresën nr. 20/13 prot., datë 15.4.2025, dhe i ka dhënë sqarimet përkatëse mbi dokumentacionin që duhej depozituar në ERE. Në këtë shkresë është vënë në dijeni dhe MIE.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 20/14 prot., datë 26.5.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues.

- Për sa më sipër, në referencë të përcaktimeve të vendimit të Bordit nr. 73/2025 dhe duke qenë se shoqëria nuk kishte përmbushur brenda afatit detyrimin për depozitimin e dokumentacionit përkatës, u vlerësua e nevojshme që t'i bëhej me dije ky fakt. Për këtë qëllim, shoqërisë iu dërgua shkresa e ERE-s nr. 20/15 prot., datë 16.6.2025. Gjithashtu, në këtë shkresë, shoqërisë iu kërkua të saktësonte nëse kërkesa e saj për shtyrje të afatit deri në muajin maj të vitit 2027 i referohet vendimit për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike apo vendosjes në punë të hidrocentralit.

- Në përgjigje dhe brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2025, me e-mail-in e datës 4.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 20/16 prot., datë 7.4.2025, shoqëria ka sjellë informacion dhe dokumentacion plotësues për sa kërkuar në këtë vendim. Po ashtu, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 20/17 prot., datë 15.7.2025, shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).

- Në vijim të sa më sipër dhe me depozitimin nga ana e shoqërisë të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, brenda afatit të përcaktuar në vendimin e pezullimit nr. 73, datë 2025, konsiderohet se efektet e pezullimit janë shuar. Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga *Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

#### **Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:**

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim) “Për ndërtimin e hidrocentralit ‘Grabovë I’” nr. 2623 rep., nr. 1238/2 kol., datë 20.11.2017; kontratën shtesë të koncesionit nr. 1020 rep., nr. 304 kol., datë 8.4.2022; kontratën shtesë të koncesionit nr. 2524 rep., nr. 945 kol., datë 15.5.2024;

- Shoqëria ka nënshkruar “Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të HEC ‘Grabova 1’”, me nr. 4091/4 prot., datë 4.11.2024, me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.);

- Është pajisur me lejen për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor nr. 230 prot., datë 31.3.2022, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujqor (KBU) Seman, për aktivitetin prodhim hidroenergjie (HEC “Grabova 1”), me një afat vlefshmërie të barabartë me afatin e kontratës koncesionare, pra për një periudhë 35-vjeçare nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.

- Është pajisur me VNM paraprake lëshuar nga AKM-ja, me afat deri më datë 20.4.2023, për të zhvilluar projektin: “Ndërtimi i HEC Grabova-1”.

#### **Kushtet dhe afatet ligjore:**

- Në kontratën e nënshkruar me MIE-n me nr. 2623 rep., nr. 1238/2 kol., datë 20.11.2017, ndër të tjera përcaktohet se koncesioni jepet për një afat prej 35 (tridhjetë e pesë) vitesh, nga data e hyrjes në fuqi të saj dhe mbaron ditën e përvjetorit të 35-të të hyrjes në fuqi të saj.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Po ashtu, në nenin 5, pika 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit së licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Si e tillë, periudha e mbetur për licencim është afërsisht 27 vjet e 4 muaj, afat ky i cili përfundon konkretisht më 20.11.2052, ndaj dhe licenca do të jetë e vlefshme deri në këtë datë.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës nr. 1238/2 kol., datë 20.11.2017 dhe nenit 1 të kontratës shtesë nr. 2524 rep., nr. 945 kol., datë 15.5.2024, shoqëria duhet të vendosë në operim hidrocentralin brenda datës 15.5.2027.

- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 11 të kontratës nr. 1238/2 kol., datë 20.11.2017, dhe në rrethanat kur shoqëria ka dokumentuar fillimin e punimeve për ndërtimin e hidrocentralit, vlerësohet që t'i lihet detyrë shoqërisë që me fillimin e operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës mbi komisionimin dhe vënien në punë të veprës. Brenda këtij afati vlerësohet që t'i lihet asaj detyrë që të përditësojë në ERE dhe informacionin përkatës për strukturën organizative.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të vendimit, në rast të mosplotësimit të kushteve të sipërcituara, ose në rast se nga ana e MIE-s depozitohet ndonjë qëndrim i ndryshëm në lidhje me vlefshmërinë e kontratës.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe kushtet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Grabova Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 1”, me kapacitet të instaluar 14.9 *mw*, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, qarku Elbasan, me afat vlefshmërie të licencës deri më 20.11.2052.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 15.5.2027.

3. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e fillimit të operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE komisionimin dhe vënien në punë të veprës, si dhe të përditësojë informacionin mbi strukturën organizative të saj.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Grabova Hydropower” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**